

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke besuar në objektivat dhe përpjekjet e vendit tonë për forcimin e luftës kundër korrupsionit, rritjen e integritetit në administratën publike dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;

Duke theksuar rëndësinë e funksionimit të një sistemi efektiv të deklarimit dhe kontrollit të pasurive, parandalimit të konfliktit të interesave dhe mbrojtjes së sinjalizuesve, si instrumente themelore për garantimin e transparencës, llogaridhënies dhe besimit të publikut ndaj institucioneve shtetërore;

Duke vlerësuar progresin e shënuar nga ILDKPKI-ja në zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, përmbushjen e detyrimeve të procesit të integritetit evropian, si dhe vlerësimet e Komisionit Evropian, OECD-së dhe GRECO-s për forcimin gradual të kuadrit institucional dhe ligjor në fushën e integritetit publik;

Duke mbështetur përpjekjet për modernizimin e metodologjive të kontrollit, zhvillimin e sistemeve elektronike, rritjen e transparencës institucionale, forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe orientimin e veprimtarisë së institucionit drejt një modeli kontrolli të bazuar në analizën e riskut dhe praktikën më të mira evropiane;

Vlerëson veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2025, në drejtim të:

Përmbushjes së plotë të të shtatë rekomandimeve të Kuvendit për vitin 2025, duke ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e kuadrit metodologjik të kontrollit, rritjen e transparencës institucionale, forcimin e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese dhe reflektimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian, OECD-së dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë në procesin e modernizimit të institucionit.

Administrimit të 4486 deklaratave të interesave private, ushtrimit të kontrollit të plotë për 655 subjekte deklaruese dhe përmirësimin e metodologjisë së kontrollit përmes aplikimit të analizës së riskut, përdorimit të indikatorëve “*Red Flags*”, priorizimit të rasteve me ekspozim të lartë ndaj korrupsionit dhe rritjes së efektivitetit të kontrollit administrativ për deklaratimet e pasurisë dhe interesave private.

Mbështetjes së procesit të reformës në drejtësi nëpërmjet verifikimit të pasurisë dhe interesave private për 177 kandidatë për organet e sistemit të drejtësisë, trajtimit me përparësi të kërkesave të institucioneve të rivlerësimit, si dhe bashkëpunimit me KLGJ-në, KLP-në, KED-në, SPAK-un, Byronë Kombëtare të Hetimit dhe institucionet e tjera përgjegjëse për garantimin e integritetit të sistemit të drejtësisë.

Kontributit në procesin e vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, duke realizuar kontrollin e plotë të deklaratimeve të interesave private për subjektet e përzgjedhura dhe duke vijuar bashkëpunimin institucional për garantimin e standardeve të integritetit në strukturat e sigurisë.

Intensifikimit të aktivitetit kontrollues dhe hetimit administrativ, duke vendosur 75 masa administrative me gjobë, si dhe duke referuar 16 raste pranë prokurorisë.

Administrimit dhe analizimit të 451 raporteve të paraqitura nga njësitë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, monitorimit të funksionimit të 711 njësive përgjegjëse në sektorin publik dhe privat, si dhe vijimit të veprimtarisë monitoruese, këshilluese dhe trajnuese për rritjen e efektivitetit të mekanizmave të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

Përmirësimin e transparencës institucionale dhe aksesit të publikut në informacion nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të Regjistrat Elektronik të Deklarimit të Pasurive, publikimit *online* të deklaratave të interesave private të personave të ekspozuar politikisht, zgjerimit të funksionaliteteve

të sistemit elektronik të deklarimit dhe forcimit të standardeve të sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Kontributit në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian, duke bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet përgjegjëse për përafrimin e legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire*, veçanërisht nëpërmjet miratimit të ligjit të ri për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, avancimit të projektligjit për konfliktin e interesave dhe zbatimit të rekomandimeve të Komisionit Evropian, OECD-së dhe GRECO-s.

Forcimit të bashkëpunimit ndërinstytucional me Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Agjencinë e Inteligjencës Financiare, organet e drejtësisë, Policinë e Shtetit dhe partnerët ndërkombëtarë, si dhe zgjerimit të bashkëpunimit rajonal me institucionet homologe, në funksion të shkëmbimit të informacionit, praktikave më të mira dhe rritjes së efektivitetit të mekanizmave të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit.

Forcimit të kapaciteteve administrative, profesionale dhe teknologjike të institucionit nëpërmjet zhvillimit të programeve të trajnimit, përmirësimit të metodologjive të kontrollit dhe analizës financiare, hartimit të planit të veprimit institucional 2026–2027 dhe orientimit të veprimtarisë drejt një modeli modern mbikëqyrjeje të bazuar në analizën e riskut, përdorimin e inteligjencës analitike dhe matjen e performancës institucionale.

Kuvendi rekomandon që Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave gjatë vitit 2026 dhe në vijim të vazhdojë punën në këto drejtime:

1. Në funksion të forcimit të efektivitetit të mekanizmave të raportimit të korrupsionit, rritjes së besimit institucional dhe garantimit të mbrojtjes efektive të sinjalizuesve, në bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, të vijojë konsolidimin e sistemit të sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve, në përputhje me standardet e Direktivës (BE) 2019/1937 përmes forcimit të funksionalitetit të mekanizmave të raportimit, mbrojtjes ndaj çdo forme hakmarrjeje, forcimit të standardeve të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së identitetit të sinjalizuesve, si dhe përmirësimit të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit për zbatimin praktik të legjislacionit në sektorin publik dhe privat.

2. Në funksion të rritjes së integritetit në vendimmarrjen publike, parandalimit të konfliktit të interesave dhe forcimit të efektivitetit të kontrollit administrativ, të rishikojë dhe të përditësojë metodologjitë e verifikimit dhe kontrollit të deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë, duke garantuar transparencë, gjurmueshmëri dhe eficiencë procedurale, si dhe duke përfshirë mekanizma të avancuar të analizës së riskut, analizës financiare dhe shkëmbimit ndërinstytucional të të dhënave.

3. Në funksion të forcimit të standardeve të integritetit dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë dhe strukturat e sigurisë, të vijojë proceset e verifikimit të kandidatëve që shprehin interes për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, si dhe të forcojë bashkëpunimin me institucionet kompetente në avancimin e proceseve të vlerësimit kalimtar dhe verifikimit të integritetit në strukturat e sigurisë dhe zbatimit të ligjit.

4. Në funksion të rritjes së efektivitetit institucional dhe modernizimit të mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes administrative, të zhvillojë më tej modelin institucional të mbikëqyrjes së bazuar në analizën e riskut përmes forcimit të kapaciteteve analitike, standardizimit të indikatorëve të performancës, përdorimit të analizës së avancuar të të dhënave në funksion të priorizimit institucional dhe eficiencës administrative, si dhe të forcojë rolin metodologjik dhe monitorues për promovimin e standardeve të integritetit dhe etikës publike, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe detyrimet që burojnë nga procesi i integritetit evropian.

5. Në funksion të forcimit të luftës kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik, të forcojë më tej bashkëpunimin ndërinstytucional me strukturat e drejtësisë, organet e zbatimit të ligjit dhe institucionet përgjegjëse për kontrollin financiar dhe administrativ, në drejtim të rritjes së efektivitetit të kontrolleve administrative, hetimeve dhe shkëmbimit operacional të informacionit, në respekt të pavarësisë kushtetuese dhe kompetencave ligjore të secilit institucion.

6. Në funksion të rritjes së transparencës institucionale, kontrollit publik dhe besimit të qytetarëve në mekanizmat e integritetit publik, të përmirësojë sistemet e menaxhimit të të dhënave dhe statistikave institucionale, si dhe të vijojë modernizimin e sistemeve elektronike të deklarimit dhe

publikimit të deklaratave të interesave privatë, duke garantuar standardet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe sigurisë kibernetike.

7. Në funksion të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga procesi i integritetit evropian dhe rekomandimet e organizmave ndërkombëtarë, të vijojë kontributin institucional në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, veçanërisht në përmbushjen e rekomandimeve të kapitullit 23, strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit dhe strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë.

8. Në raportin vjetor të veprimtarisë të paraqesë një analizë të strukturuar për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, nivelin e përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit Evropian, GRECO-s dhe OECD-së, si dhe të detyrimeve që burojnë nga procesi i integritetit evropian dhe IBAR-i, duke evidentuar masat e ndërmarra, rezultatet e arritura, ndikimin e tyre në forcimin e sistemit të integritetit publik, si dhe çështjet që kërkojnë masa të mëtejshme institucionale.

9. Në funksion të konsolidimit të sistemit kombëtar të integritetit dhe përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian, të forcojë veprimtarinë metodologjike, këshilluese dhe monitoruese ndaj autoriteteve publike për zbatimin efektiv të legjislationit në fushën e deklaratimit të pasurisë, konfliktit të interesave dhe mbrojtjes së sinjalizuesve, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian dhe objektivat e IBAR-it.

10. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2026.

11. Të ndërmerren masat e nevojshme për forcimin e kapaciteteve institucionale të ILDKPKI-së, përfshirë ngritjen e strukturës përgjegjëse për administrimin e procedurave që lidhen me zbatimin e legjislationit për mbrojtjen e sinjalizuesve, në funksion të ushtrimit efektiv të kompetencave të reja të institucionit dhe përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe objektivave të IBAR-it.

Miratuar në datën 16.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi